



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:031156
Datë: 30.01.2025
Numri i dokumentit: 06782687

C-IV-14-3270

Ankuesi

S B fsh. R i M, Lipjan.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Agim Ramadani”, nr. 23, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtare Hajrie Shala, me 27 janar 2025, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN052-1539, i datës 31 mars 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 25 prill 2014, ankuesi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. PRN052-1539, të datës 31 mars 2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të pa paguara, në shumë prej 2,880.00 € nga NSH “Feronikeli” (në likuidim). Ankuesi ka pohuar se AL-ja ka nxjerrë vendime me të cilat refuzon kërkesat për paga të pa paguara. Sipas pohimeve të ankuesit ai nuk posedon prova shtesë të cilat janë kërkuar nga AL-ja. Ai i ka bashkëngjitur ankesës kopjen e vendimit të AL-së PRN052-1539 të dt. 31.03.2014, kopjen e vendimit me numër 1587 i dt. 17.03.1994.

Me dt. 13 nëntor 2024, gjykata ka lëshuar një urdhër për ankuesin ku ka kërkuar prova shtesë në lidhje me ankesën. Sipas fletë kthesës pala e ka pranuar urdhrin me 19 nëntor 2024, por nuk ka parashtruar përgjigje në urdhër dhe prova të kërkuara shtesë.

Me 24 janar 2025, e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën ka pohuar se AL-ja ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore janë aplikuar saktësisht. Po ashtu e paditura ka pohuar se kërkesa ishte dorëzuar jashtë afatit për parashtrimin e kërkesave dhe parashtruesi nuk ka dhënë asnjë arsytim bindës për parashtrimin e vonuar të kërkesës. E paditura ka pohuar se AKP-ja i regjistron kërkesat apo shkresat që merr dorazi apo nëpërmjet postës dhe nuk ekziston asnjë dëshmi për të kundërtën siç ka pretenduar ankuesi, andaj ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazuar dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar, kurse vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN052-1539, i datës 31 mars 2014, vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (Ligjit mbi Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të Nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, lidhur me Nenin 398 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, Gjykata konstaton se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr këtë Aktgjykim pa caktuar seancë kryesore.

Ankuesi nuk e ka dorëzuar kërkesën në Autoritetin e Likuidimit të AKP-së brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKM-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. NSH “Feronikeli” kishte hyr në proces të likuidimit nga data 4 korrik 2006. AKM kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të NSH-së, ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të NSH “Feronikeli” (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri me datën 26 shtator 2006. Publikimet ishin bërë në shtypin ditor “Koha Ditore” me 26 korrik 2006 dhe në web sajtin e AKM-së.

Nga shkresat e lëndës del se ankuesi kërkesën e tij Autoritetit të Likuidimit e kishte parashtruar me datë 17 korrik 2007.

Nga kjo konstatohet se ankuesi kërkesën e tij te Autoriteti i Likuidimit e kishte parashtruar pasi që kishte kaluar afati i parashtrimin të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKM-ja. Ankuesi në ankesë nuk ka sjell asnjë dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij kaq të gjatë në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit.

.

Nga data e fundit për parashtrimin e kërkesave 26 shtator 2006, e deri në datën e parashtrimit të kërkesës së tij me 17 korrik 2007 në Autoritetin e Likuidimit, kanë kaluar më shumë se nëntë muaj. Andaj, kërkesa dorëzuar në AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pavlefshme, si rrjedhojë e saj edhe ankesa e parashtruar në Dhomën e Posaçme kundër vendimit në fjalë refuzohet si e pabazuar.

Neni 37.4.4.1 i Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përcakton se kërkesat që konsiderohen të jenë të pas afatshme sipas afatit të kufizuar të përcaktuar me ligjet e aplikueshme si dhe kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë të rregullt apo me kohë, refuzohen.

Njëherit një zgjidhje e tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (C-IV-13-0003, C-IV-13-0652, C-IV-13-1754, C-IV-13-2063 dhe AC-I-14-0090) për refuzimin e ankesave kundër vendimeve të AL, në rastet kur kërkesat kreditore janë parashtruar jashtë afatit për paraqitjen e tyre në AL.

Edhe pse gjykata përmes urdhërit kërkoi nga ankuesi të plotësoi procedurën e provave me prova shtesë sa i përket vonesës dhe bazueshmërisë së kërkesës duke dorëzuar dokumentacionin i cili do të të vërtetonte se të njëjtit Nsh-ja i ka mbetur borxh shumë e kërkuar, ankuesi nuk iu përgjegj urdhërit të gjykatës deri në marrjen e kërrij vendimi

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Hajrie Shala